




ARRU/UTSH/USH – 09/04-01/2017
30.12.2016

Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 19., paragrafi 1 të *Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit*, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016 ("Ligji").

Konform Nenit 15. Aprovimi i tarifave të shërbimit, të Rregullores ARRU Nr. 07/2016 për Përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë, datë 23 Shtatori 2016.

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të ujit të trajtuar me shumicë të KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për procesin tariforë 2015-2017, qëndrueshmërinë financiare dhe analizave të të dhënave të realizuara të performancës së saj për furnizim të ujit të trajtuar me shumicë të Veriut të Qytetit të Mitrovicë, lëvizjeve inflatore në vend të periudhës Nëntor 2016 – Dhjetor 2015 dhe rrethanave socio ekonomike në vend.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËRCAKTIM I TARIFAVE PËR FURNIZIM TË UJIT TË TRAJTUAR ME SHUMICË PËR APLIKIM NGA KRU "MITROVICA" SH. A. MITROVICE PËR FURNIZIM TË VERIUT T 0203 QYTETIT TË MITROVICËS, GJATË PERIUDHËS TARIFORE 01. 06. – 31. 12. 2017 NGA PROCESI TARIFOR 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullores ARRU Nr. 07/2016.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifës së Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për aplikim nga KRU "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë, të cilës i kërkohet të aplikoj tarifën e shërbimit sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit me rastin e faturimit të ujit me shumicë të trajtuar për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

Gjatë vitit tariforë 2017 të periudhës së procesit rregullatorë të tarifave 2015 - 2017, KRU "MITROVICA" sh. a., Mitrovicë, do të furnizojë pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës me ujë të trajtuar me shumicë me tarifën e përcaktuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, kolona 7.

Tabela 1. Tarifa e procesit rregullatorë për aplikim gjatë vitit 2015, nga procesi rregullatorë 2015-2017

Nr.	Përshkrimi i shërbimit me ujë	Njësia matëse	Tarifa historike e vitit 2014	Tarifa e aplikueshme për faturim gjatë vitit 2015	Tarifa e aplikueshme për faturim nga 01.06-31.12.2016	Tarifa e aplikueshme për faturim gjatë vitit 2017
1	2	3	4	5	6	7
1	Ujë me shumicë i trajtuar	€/m3	0.16	0.17	0.17	0.17

Tarifa e aplikuar është pa TVSH.

4. Aplikimi i tarifës

Tarifa e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të trajtuar e aprovuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit do të aplikohet nga: **01.01.2017 gjerë me 31. 12. 2017.**

5. Procedurat e rishikimit të tarifës

Tarifat e aplikuara për vitin 2017 mund të rishikohen për përcaktim dhe aplikim gjatë vlefshmërisë së tarifave të këtij procesi rregullatorë të periudhës së mbetur tarifore 2015-2017, në përputhje me aktet rregullative të ARRU-së, duke marr në konsideratë performancën e KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifës së Shërbimit

KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë është e obliguar të njoftojë marrësin e Shërbimit të Ujit të Trajtuar me Shumicë, me tarifën e aprovuara sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit dhe të bëjë nënshkrimin e Kontratës për këtë shërbim me te dhe së paku një herë me faturën e parë të ngarkesës tarifore sipas kësaj UTSH-je ti bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën informohet marrësi i shërbimeve.

6. Apelet


KRU "MITROVICA" Sh. A., ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda një muaj, nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 41.1, Komisioni Shqyrtues, Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të datës 30 Janar 2016.

7. Gjuha Zyrtare e Urdhëresës së Tarifave

Kjo Urdhëresë e Tarifave nxjerrët dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:

- 1) Shqip,
- 2) Serbisht, dhe eventualisht në
- 3) Gjuhen Angleze.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i Gjuhës Shqipe.


Raif Preteni, Drejtor i ARRU